Thyamis

ALB

"...në aspektin gjuhësor, shumë studiues dhe gjuhëtarë, duke përfshirë edhe Eqerem Çabej, prejardhjen e emrit Çamëri, e lidhin ngushtë me emrin e lumit Thyamis që njihet si territor shqiptar, gjë që provon autoktoninë e kësaj krahine."

Nr. 5 • Tetor 2013
www.cameriainstitute.org

Buletin i Institutit të Studimeve për Çamërinë

Donato Martucci: "Përshkrimet e bukura të Çamërisë ..."



ALI DEMI

Ekspedita gjermano-shqiptare e vitit 1957 dhe libri "Këngët e çamëve"

Në brendësi të buletinit do të gjeni disa foto të veçanta të fotografit Fred Boissonnas të realizuara në Çamëri

Këtë buletin kemi vendosur ta emërtojmë *"Thyamis"* për shkak të lidhjes së ngushtë të emrit Çamëri me emrin e lumit që e përshkon atë, *Thyamis*-in antik. Për prejardhjen e emrit Çamëri, trajtesat më të hershme u takojnë studiuesve të huaj, si W.M.Leake, Pouqueville, etj, të cilët janë përqendruar tek toponimia. Gjuhëtari shqiptar Eqerem Çabej, mbështet të njëjtën tezë duke vërejtur vazhdimësinë e dy termave nga *Thyamis* në *çam*, që shpjegohet nëpërmjet ligjësive fonetike të shqipes: Pjesa e parë *(- thy)* e kompozitës *(-thyamis)*, rrjedh nga folja shqipe *-thyej*, ndërsa pjesa e dytë *(-am)*, nga emri shqip ilirisht *-amë, ama, ëma*, në kuptimin *amtar*, e cila si formë fjalëformuese (*thy+am=thyam)*, shkon në përfundim logjik të shprehjes shqipe, *ama e thyer*, me kuptimin e *thyerjes së amës pellazgjike illire*. Mendohet se etimologjia shqipe e emrit të hidronomit *Thyamis*, linguistikisht, lidhet me formën tjetër të shqipes, ku nga *"thy amë"*, u krijua forma sinonimike *ça amë* që i përgjigjet folja shqipe *çaj (çarja e amës-ëmës)*. Në këtë mënyrë, sipas mbështetësve të kësaj teze, është krijuar forma shqipe *-ça am(ë), (u) ça ama*, ku me rënien e njërës zanore *-a*, formohet emërtimi *çamë (ça+amë)*. Në trajtën e pashquar, emrit i shtohet prapashtesa *-ri*, duke formuar toponimin *Çamëri (ça+amë+ri)*.

Stafi i buletinit:

Drejtoi :
Kaltra Bardhi dhe Ines Dako
Redaktoi në shqip :
Kaltra Bardhi
Grafika :
Alfred Nikolla
Një falenderim i veçantë për :
Prof. Donato Martucci
Prof. Enver Kushi
Botues :
Instituti i Studimeve për Çamërinë (ISÇ)
Drejtor i Institutit të Studimeve për Çamërinë:
Gjergj Xhafa

INSTITUTI I STUDIMEVE PËR ÇAMËRINË
INSTITUTE OF CHAM STUDIES

Instituti i Studimeve për Çamërinë (ISÇ) është një organ jo-fitimprurës. U themelua në maj të vitit 2004 në Tiranë, me iniciativën e një grupi prej 17 intelektualësh të fushave të ndryshme, si të shkencave politike, juridike, historike, sociologjike, të marrëdhënieve ndërkombëtare etj. ISÇ është regjistruar dhe funksionon në bazë të statutit dhe rregullores së vet, në harmoni me ligjet e shtetit shqiptar dhe të drejtës ndërkombëtare.

Qëllimi i këtij newsletter-i është të bëjë të mundur shpalosjen në masë të gjerë të historisë së Çamërisë, etnografisë, etnolinguistikës, dokeve, zakoneve dhe kulturës së bukur të krahinës së Çamërisë. Nëse i gjithë komuniteti çam kërkon një zgjidhje të kënaqshme, hapi i parë është sigurisht kthimi pas në të kaluarën, për të kujtuar gjithmonë historinë dhe arsyen që kërkojmë drejtësi. Synimi i newsletter-it tonë është të tregojë vlerat që populli çam ka patur dhe vazhdon të ketë, për t'i trashëguar ato edhe tek brezat e rinj, nëpërmjet kulturës dhe dialektit që e karakterizon.

Për këtë arsye, Instituti i Studimeve për Çamërinë me botimin e këtij newsletter-i ka për synim që nëpërmjet aktiviteteve të shumëllojshme dhe me tematikat e ndryshme që trajton, të ndërgjegjësojë masën për vlerat e këtij komuniteti.

Historiku
Çamët gjatë luftës antifashiste — *fq 3 - 4*

Qytetet
Këto troje na përkasin!
Preveza — *fq 5 -6*

Analizë kulturore
Enver Kushi: Ekspedita gjermano-shqiptare e vitit 1957 dhe libri "Këngët e çamëve" — *fq 7 -8*

Intervistë
Donato Martucci: "Përshkrimet e bukura të Çamërisë më kanë shtuar kuriozitetin për ta vizituar" — *fq 9 - 10*

Personalitet
Ali Demi — *fq 11*

Aktivitete
Shkolla verore: 1913 - 2013, 100 vjet çështje çame — *fq 12 - 13*

Botime: *Kushtetuta, Evropa dhe minoriteti çam* — *fq 14*

Poezi — *fq 15*

ÇAMËT GJATË LUFTËS ANTIFASHISTE

Greqia ka qenë ndër shtetet e para në Ballkan në të cilat triumfoi fashizmi. Në gusht të vitit 1936, Joan Metaksai vendosi diktaturën fashiste. Viktima e parë që i vuajti pasojat, ishte popullsia çame. Qeveria greke bëri të pamundurën që të përçante popullsinë shqiptare çame nëpërmjet përdorimit të disa metodave: duke u përpjekur të kundërvejë të krishterët ndaj myslimanëve; duke u ngarkuar taksa të rënda me synmin për t'i detyruar të emigronin në Shqipëri ose gjetkë; u ndryshuan emrat shqiptarë të fshatrave Spatar, Galbaq, Picar, Varfanj, Arpicë me emra grekë, respektivisht Trikoforo, Ella, Aetos, Parapotume, Perdhika, duke i kolonizuar me grekë, me qëllim ndryshimin e raporteve të popullsisë.

Para hyrjes së ushtrisë fashiste italiane në Greqi, qeveria greke filloi një fushatë të re masakrash dhe krimesh të tmerrshme kundrejt popullsisë shqiptare. Dy muaj para konfliktit italo-grek, qeveria fashiste e Metaksait kreu një akt të paprecedent në historinë botërore. Të gjithë meshkujt nga 16-70 vjeç, që numëroheshin mbi 5000 burra, u burgosën dhe u dërguan në ishujt e largët të Egjeut. Ky veprim u krye në bazë të vendimit të marrë më parë në Gumecinë nga një mbledhje e kryesuar nga Dhespoti i Janinës, Spiridoni.

Gjatë përgatitjeve të luftës me Greqinë, Italia filloi ta përdorte në interes të saj gjendjen diskriminuese të shqiptarëve të Çamërisë.

Shpërthimi i luftës italo-greke në vitin 1940 e thelloi tensionin politik në Çamëri. Ishin të shumta përpjekjet e pushtuesit për ta patur bashkëpunëtor minoritetin shqiptar, por pavarësisht se popullsia çame gjatë regjimit fashist të Metaksait kishte vuajtur shumë, ajo përgjithësisht mbajti një qendrim neutral ndaj palëve në konflikt.

Pas thyerjes së ushtrive italiane dhe tërheqjes së tyre nga Greqia, dhuna dhe terrori i qeverisë së re greke mbi popullsinë shqiptare të Çamërisë, u bë më intensive. Të burgosurit dhe të internuarit çamë u liruan vetëm pas pushtimit të Greqisë nga ushtritë gjermane, në një gjendje të rëndë shëndetësore dhe shpirtërore.

Pas pushtimit të Greqisë nga gjermanët, pritej që çamët e kthyer nga internimi të hakmerreshin ndaj vuajtjeve të shkaktuara nga forcat shoviniste greke. Por ndodhi krejtësisht e kundërta. Për të përballuar gjendjen e rëndë të krijuar nga pushtuesit e rinj gjermanë, çamët zgjodhën rrugën e bashkëpunimit dhe të bashkëjetesës. Për këtë qëllim, u organizuan dy mbledhje në Koskë dhe në Spatar. Njerëz me ndikim në krahinë si Musa Demi, Shuaip Llajo, Isuf Izeti, Xhaferr Çafuli, Jasin Sadiku dhe shumë të tjerë, punuan me përkushtim për të krijuar atmosferën e mirëkuptimit midis komunitetit grek dhe shqiptar. Madje fshatarët e Varfanjit, Salicës etj., dërguan përfaqësuesit e tyre në fshatrat e krishtera, ku burrat ishin larguar nga frika e hakmarrjes, duke i siguruar që nëse do të ktheheshin, nuk do t'u ndodhte asgjë e keqe.

Madje, për shkak se në zonën e Gumenicës dhe të Filatit ishte bërë rregull që asnjë grup i rezistencës greke nuk duhet të dilte në zonat e lira pa qenë i shoqëruar nga një shqiptar çam, shumë çamë dolën para gjykatave të pushtuesit dhe u burgosën. Duke patur parasysh këtë realitet të mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit midis dy komuniteteve, studiuesi Niko Zhangu ka shkruar: "Nëse shqiptarët çamë do të ishin kriminelë, do të ishin zhdukur të gjithë fshatrat e krishterë të Thesprotisë rreth fshatrave shqiptaro-çame." Por ky mirëkuptim dhe bashkëpunim ndërmjet dy komuniteteve, për qarqet shoviniste greke nuk ishte i pranueshëm. Për të nxitur përçarjen, ata bënë të mundur vrasjen e çamëve me influencë si Jasin Sadiku. Jahja Kasemi, etj. Më tej, me vrasjen e shqiptarëve të tjerë nga çeta e Koçnikollës, ngjarjet morën një drejtim të rrezikshëm. Për këto arsye, disa krerë të Çamërisë, për mbrojtje, formuan një batalion me rreth 300 vetë, që përbënin vetëm gjysmën e efektivit të një batalioni të zakonshëm. Megjithatë, batalioni veproi brenda kufijve politikë të shtetit shqiptar. Populli u armatos, por vetëm për vetëmbrojtje nga shovinizmi grek. Popullsia çame nuk pranoi të bashkëpunonte me gjermanët dhe nuk i përdori armët

Historiku

kundër popullsisë greke, por përkundrazi, u rezistoi me vendosmëri përpjekjeve për ta hedhur kundër elementit grek.

Ajo që i shqetësoi më shumë forcat shoviniste greke, ishte ngritja e këshillave shqiptarë në të gjithë Çamërinë. Në mars të vitit 1943, u formua çeta e parë mikste, e cila bashkëpunonte me EAM-in. As biografët e Zervës, si Mihal Miridhaqi nuk e mohojnë kontributin dhe pjesëmarrjen e çamëve myslimanë në radhët e rezistencës antifashiste greke, në formacionet e ELLAS-it dhe të EAM-it. Historiani i lartpërmendur thekson se çamët nxorrën mbi 1000 luftëtarë, pa marrë parsysh edhe qindra të tjerë që punonin në terren. Vetëm në radhët e ELLAS-it dhanë jetën rreth 68 partizanë çamë.

Në dimrin e viteve 1942-1943, popullsia çame filloi të organizohej në luftën kundër fashizmit, madje që në verën e vitit 1942, u krijua në Filat grupi ilegal i rezistencës antifashiste i përbërë nga Njazi dhe Kasem Demi, Mustafa Sulo, Dervish Dojaka, Muharrem Demi, Braho Karasani, Sami Alushi, Tahir Demi, Vehip Huso e shumë të tjerë. Ata punuan në rrëzë të kufirit të Shkallës së Zorjanit për organizimin e rezistencës, për krijimin e bazave të luftës, për popullarizimin e ideve të Kartës së Atlantikut, e cila u garantonte popujve e pakicave etnike liri, barazi dhe të drejtën e vetëvendosjes pas fitores mbi fashizmin. Në shkurt të vitit 1943, u krijua "çeta "Çamëria" dhe më pas batalioni "Çamëria", i cili në shtator të vitit 1943 zhvilloi betejën e famshme të Konsipolit kundër gjermanëve, që zgjati 55 ditë. Ajo betejë u shqua për pjesëmarrjen e gjerë të popullsisë së Çamërisë, të Delvinës dhe të minoritetit pa dallim kombësie apo shtresash shoqërore. Në mars të këtij viti u krijua formacioni i parë mikst shqiptaro-grek. Në pranverë të vitit 1944, në Qeramicë, u formua Batalioni IV "Ali Demi" me më shumë se 500 djem çamë. Ky batalion, hyri në përbërje të Regjimentit XV të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Greke (EAM). Gjatë luftimeve në rrugën Janinë-Gumenicë, Koskë, Smartë e Lopës, si edhe në Mallun, ranë trimërisht dëshmorët Muharrem Myrtezai, Ibrahim Halluni, Husa Vejseli etj. Gjithashtu, shumë çamë morën pjesë në Brigadën VI, VII, IX dhe XI të ushtrisë greke. Edhe misioni britanik që kreu hetime në Çamëri, nuk e ka mohuar pjesëmarrjen e çamëve në radhët e EAM-it.

Nacionalistët shqiptarë synonin bashkimin e Çamërisë me Shqipërinë, ndërsa përkrahësit e Zervës e kundërshtonin me çdo mënyrë një gjë të tillë, madje prisnin rastin e volitshëm për një sulm vendimtar mbi Çamërinë, për të ushtruar mbi të shfarosjen kombëtare.

Në anën tjetër, popullsia çame gjendej përballë veprimtarisë së ethshme antishqiptare të EDES-it të Zervës, që e kërcënonte me shfarosje. Zerva u përpoq ta përdorte popullsinë çame si forcë kundër ELLAS-it. Kjo manovër djallëzore, së pari, synonte ta fuste popullsinë shqiptare në kurthin e luftës midis forcave politike në Greqi me synimin që të krijohej justifikimi dhe terreni i përshtatshëm për shfarosjen dhe dëbimin e saj. Së dyti, të shtonte forcat për të goditur EAM-in kundërshtar, pra të sakrifikonte popullin shqiptar. Në bisedimet e zhvilluara në fshatin Mininë më 3-6 korrik të vitit 1944, të dërguarit e Zervës i parashtruan popullsisë çame këto kushte:

1. Çarmatimin e plotë;
2. Mobilizimin e përgjithshëm të popullsisë çame në radhët e EDES-it, si edhe të pranonin pushtetin e EDES-it në Çamëri.

Populli çam u gjend në pozita të vështira. Ai nuk pranoi të futet në luftën midis forcave rivale në Greqi dhe si ndëshkim, Zerva filloi ndaj kësaj popullsie sulmin e përgjithshëm të 8 korrikut 1944, që ka patur pasoja të tmerrshme. Ky fakt pohohet edhe në letrën e Këshillit Antifashist të Çamërisë dërguar: qeverisë greke të Bashkimit Kombëtar, Shtabit të Përgjithshëm të Mesdheut, qeverive të Fuqive të Mëdha, Komitetit Qendror të EAM-it, guvernatorit të Epirit dhe Komitetit Panepirot të EAM-it.

Duke u bazuar në faktet e patjetërsueshme historike, duhet theksuar se fitorja mbi nazifashizmin, në thelb, ka kontributin e burrave të Çamërisë që luftuan me armë në dorë dhe që vuajtën internimin në kampet e përqëndrimit në Itali dhe Gjermani.

PREVEZA

Qyteza e Prevezës u themelua në vitin 290 para erës sonë, nga mbreti Pirro i Epirit. Emri Prevezë e ka origjinën nga emri i qytetit të lashtë të ndërtuar prej të famshmit Pirro. Ky qytet ndodhej ose në Prevezën e sotme ose në atë të qytetit të Nikopolit, i ndërtuar prej Oktavianit, gërmadhat e të cilit duken edhe sot. Në periudhën e vonë mesjetare, një qytet i ri u themelua me emrin aktual të Prevezës, i cili më 1499-ën kaloi në duart e Venedikut. Dëshmi e kësaj kohe është kalaja, dëshmia e vetme thelbësore e mbetur nga ish-fortifikimi i qytetit, me një pamje të mahnitshme mbi gji.

Preveza ka qëndruar për shumë kohë në dorë të francezëve, bashkë me ishujt e Dodekanezit. Në vitin 1798, Ali Pashë Tepelena e mori qytezën nga francezët me luftë dhe që prej asaj kohe ajo bën pjesë në territorin otoman.

Qyteza ndodhet në skajin jugor të Shqipërisë, në fund të një gadishulli që mbyll anën perëndimore të gjirit të Artës, në bregun verior të grykës që mban të njëjtin emër. Ndodhet 92 km në jugperendim të Janinës. Pozicioni i saj shumë i bukur, ngjason me atë të Stambollit.

Në qytet ka patur dy xhami, njëra e ndërtuar nga Ali Pashë Tepelena, ndërsa tjetra nga Ahmet Aga Dino, si edhe dy teqe, disa tyrbe, një shkollë plotore, dy shkolla fillore greke, një për vajza dhe një për djem, një mulli me avull, një punishte për regjjen e lëkurës dhe disa fabrika sapuni dhe vaji.

Ka patur një liman mjaft të frekuentuar, që bënte shumë tregti me skelat e Triestes, Korfuzit, të Greqisë dhe të Italisë. Në veri dhe brenda gjirit ka patur edhe një liman më të madh të quajtur Vati ose me emrin Drin, i cili ka qenë

liman i qytetit të lashtë të Nikopolisit. Sanxhaku i Prevezës ka qenë më i vogli ndër katër sanxhaqet që formonin vilajetin e Janinës. Ndodhej në skajin jugor të Shqipërisë dhe përbëhej nga gjysma jugore e krahinës së Çamërisë. Nga veriu kufizohej me sanxhakun e Janinës, nga lindja me kufrin grek, nga jugu

Qytete

me gjirin e Nartës dhe me grykën e Prevezës, ndërsa nga perëndimi dhe jugperendimi me detin Jon. Pjesa më e madhe e tokës përbëhej nga kodra të ulëta, me kullota të bukura, të veshura me portokalle dhe limona.

Lumi i Nartës rridhte në lindje të sanxhakut, duke ndarë kufirin me Greqinë. Në tokat e sanxhakut ka patur edhe dy lumenj të tjerë, njëri prej të cilëve ishte Lorosi, që mbledh ujërat që zbrisnin nga malet e Olickës, të cilat ndodheshin në sanxhakun e Janinës dhe derdheshin në gjirin e Nartës. Ky lum e kishte kthyer në një kënetë fushën që ndodhej midis Nartës dhe Prevezës. Tjetri është lumi Ferari, që buron prej maleve të Sulit, drejtohet nga veriu, duke marrë me vete lumin Vovo dhe në fund derdhet në detin Jon. Ky është lumi Akeron që mitologjia greke e quante skëterrë. Popullsia arrinte në 55.000 banorë, shumica myslimanë, më pak të krishterë dhe një numër i kufizuar çifutësh. E gjithë popullsia myslimane dhe shumica e të krishterëve kanë qenë shqiptarë, përveç të krishterëve të vetë qytezës së Prevezës dhe të vendeve kufitare me Greqinë, që ishin grekë. Kazaja përfshinte 179 fshatra, 48 xhami dhe mesxhide, dy medrese, 30 shkolla (fillore kuranike), 220 kisha e manastire, 450 dyqane, 50 mullinj etj. Prodhoheshin drithëra të ndryshme dhe me shumicë ullinj, portokalle, limona etj. Një sasi e madhe e vajit të ullirit eksportohej.

Sot Preveza është një nga vendbanimet turistike më të gjallëruara dhe të organizuara në bregdetin e Jonit, duke ofruar në zonën përreth, një numër të gjerë të plazheve interesante dhe gjireve me ujëra të kristalta. Klima në Prevezë është e butë dhe e këndshme, ku rrallëherë bie dëborë.

NGA ENVER KUSHI

EKSPEDITA GJERMANO-SHQIPTARE E VITIT 1957 DHE LIBRI "KËNGËT E ÇAMËVE"

Këtë vit mbushen 56 vjet nga ekspedita gjermano-shqiptare në Shqipëri dhe në Çamërinë e zhvendosur në Fier dhe Vlorë (Babicë e Skelë), si edhe 48 vjet nga botimi në Berlin i librit "Muzika popullore shqiptare - këngët e çamëve." (Albanische Volkmusik. Gesange der Camen).

Kam patur fatin të jem një nga miqtë e Prof. Ramadan Sokoli, një nga dijetarët e rrallë shqiptar, njohës dhe studiues i rrënjëve të kulturës popullore shqiptare, kryesisht i rrënjëve të tingullit shqiptar. Takimet dhe bisedat e mia të shpeshta me të, kanë qenë nga më frytdhënëset dhe befasueset.

Ka qenë pikërisht Prof. R. Sokoli i pari që më ka folur për ekspeditën gjermano-shqiptare te çamët e Fierit dhe Vlorës, si edhe për një këngë të rrallë vaji, e inçizuar në Skelë dhe e interpretuar nga 40-vjeçarja, Hamide Shabani.

Grupi i studiuesve gjermanë erdhi në Shqipëri në maj të vitit 1957 dhe përbëhej nga Doris Stockman, Wilfried Fielder, Erich Stockmann dhe Johan Kyritz.

Ekspedita ishte nismë e Institutit të Foklorit Gjerman pranë Akademisë së Shkencave të Gjermanisë. Ajo u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës së Shqipërisë. Nga pala shqiptare morën pjesë Ramadan Sokoli dhe Albert Paparisto.

Siç shkruajnë muzikologët gjermanë, qëllimi i tyre kishte qenë inçizimi i këngëve popullore dhe melodive instrumentale me ndihmën e aparateve moderne të marrjes, për të kontribuar në dokumentimin e parë të rëndësishëm të muzikës popullore shqiptare. Në këtë drejtim, Shqipëria kishte mbetur një njollë e bardhë në hartën e muzikës popullore të Europës Juglindore. U zgjodh Shqipëria e Jugut për të realizuar qëllimin dhe konkretisht, siç shkruajnë autorët gjermanë, "për të marrë shënime për muzikën popullore të tre grupeve shqiptare në Jug: toskëve, labëve dhe çamëve, si edhe një praktikë këndimi shumë e vjetër, siç ishte polifonia. Instituti i Foklorit Gjerman në Berlin, vuri në dispozicion të grupit tre magnetofonë me mikrofonë dinamikë, 3 aparate fotografikë dhe një aparat me film të ngushtë. Ata japin të dhëna për shtrirjen e toskëve, labëve dhe çamëve, si edhe zonat ku kanë inçizuar: krahina pranë Liqenit të Ohrit, Mokër, pllaja e lartë e Korçës, krahina e Devollit, malësia e Skraparit, fusha e Kolonjës, fusha e Vjosës, Myzeqe, Mallakastër, Berat, Elbasan, Lushnjë, Këlcyrë, Gjirokastër, Sarandë, Borsh, Himarë, Dukat, Vlorë dhe Kurvelesh. Inçizime janë bërë edhe në zonën e minoritetit grek dhe nomadët vllehë.



Mendoj se nuk është rastësi këmbëngulja e studiuesve gjermanë për inçizimin e këngëve çame. Jam i bindur se ata vinin në Shqipëri me njohuri për gjeografinë, historinë dhe kulturën e shqiptarëve të të gjitha trevave. Me siguri njihnin mirë edhe punën e albanologëve të shquar si Hahn, Bopp, Jokli, apo të atyre që janë marrë me kulturën popullore shqiptare si Habenlandt, Nopça, Lamberc, Vaigand, Pedersen (që ka publikuar edhe përralla ngaÇamëria). Në qoftë se do të bënim një rikthim imagjinar rreth 40 vite më parë, pra në vitin 1957, kohë kur u organizua edhe ekspedita shqiptaro-gjermane, do t'i vërenim ende të freskëta plagët dhe dhimbjet e popullsisë çame. Është gjallë brezi që e ka parë me sytë e tij tmerrin dhe gjëmën e madhe. Fëmijët e viteve '44 - '45 janë rritur, por në sytë e tyre ruhen pamjet e tmerrshme të tragjedisë. Të vdekurit, lënë bokërrimave të tokës çame, u trokasin netëve dhe u prishin gjumin të gjallëve, trazojnë kujtimet. Por jo vetëm kaq. Është zhvendosur relievi i kulturës çame, janë zhvendosur vallet e tyre epike, këngët, baladat, përrallat, gojëdhënat dhe kjo është një zhvendosje e një lloji tjetër, më pak e dukshme, por më ulëritëse dhe më tragjike se plagët e bartësve të tyre.

Analizë kulturore

Inçizimi i këngëve çame është bërë në Fier, Skelë dhe Babicë të Vlorës. Këngetarët ishin, siç pohojnë studiuesit, nga i njëjti fshat ose të paktën, nga e njëjta krahinë. Kështu, këngëtarët e Skelës, para vitit 1944, banonin në fshatrat Arpicë, Volë dhe Vaje të Gumenicës. Këngëtarët e Fierit e kishin origjinën nga Mazreku, ndërsa grupi i Babicës nga fshatrat midis Mazrekut dhe Margëlliçit.


Wilfried Fiedler

Në tërësi, janë 30 këngë të inçizuara. Nga këto, në Fier 8 këngë ("Çelo Mezani", "Mua më ra taksimi", "Qaj me lot o Çamëri", "Kalesh' e Xhixhosë", "Luli me nishan në ballë", "Ditën që u mor nisia", "Meçovë e zeza Meçovë"); në Babicë 8 këngë ("Kjo anë e lumit", "Ç'ke flamur që s'valon", "Janinë e zeza Janinë", "Ne porta të shkova", "Thirri talili në malë" "Kamerini mal me fletë", "Hiq kadale vallen'o", "E mjera merr me zë"); në Skelë 14 këngë ("Ulu mal të shoh Kastrinë", "Kënga e Çelo Mezanit", "Ti moj kull' e Livadhisë", "Ti më qesh , ti me ta", "Barbaro, Vasiliko", "Moj Mine, Minusheja", "Ti fletë e lejmonit t'bardhë", "Ra dielli mbi bajame", "Të martën që me natë", "Trëndelo, moj trëndelinë", "Ç'u nis djali për kurbet", "Nani-nani more djalë", "Sha kriet tat babatho".

Libri në fjalë, botim i vitit 1965, me 302 faqe dhe me autorë Doris Stockmann, Wilfried Piedler dhe Erich Stockmann, përbëhet nga këto pjesë: Pjesa e parë: "Gjurmimi i muzikës popullore shqiptare deri në vitin 1957", "Ekspedita e mbledhjes shqiptaro-gjermane e vitit 1957 dhe shfrytëzimi i saj", "Vërejtje etnografike mbi çamët", të shkruara nga Erich Stochman; Pjesa e dytë: "Gjurmime në muzikën vokale çame" e ndarë në kapitujt "Paravërejtje të përgjithshme", "Problemet dhe metodat e transkriptimit", "Vërejtje botimi dhe shpjegimi i shenjave", "Terminologjia", "Figura dhe dhënia e formës së këngëve çame" "Këngë bordune polifonike", "Këngë korale jo bordunale", "Këngë burrash", "Këngë grash", Këngë solo".

Pjesa "Transkriptime" dhe pjesa e fundit, përmbajnë tekstet në variantin shqip dhe përkthimin në gjermanisht.

Mes shumë të dhënave, më ka bërë përshtypje një fakt që japin studiuesit gjermanë: kur inçizuam këngë vajtimi në Babicë, këngëtarja u prek aq shumë, duke i harruar të gjithë të pranishmit, saqë ne u detyruam ta ndërprisnim inçizimin. Teksti i këngës është ky:

Sha (pasha) krietë tat, babatho,
Sha kurmin tënd baba,
Ku do të të gjëjmë ne tani,
Që na lëshoe
Ore babatho e?
Do të të gjuajnë djeltë, baba:
Se neve nuku jemi në dhenë tënë babatho,
Se neve jemi muhexhirë në vend të huaj babatho,
Mos të ka pikunë vendi jot,
Se ke ardhurë në botë të Shqipërisë, Baba ore!
Do të të palosi bot' e Vlorësë,
Se ashtu e kishim të shkruarë babatho,
Sha kurmin tën, ore baba, ore,
Po qe jedh' ndo-jerë të vemi në
Në atë vatanë tën' ore, vatrëz o?
Që jemi bërë muhaxhin' o,
Në botë të Shqipërisë o babatho.

Vlera të mëdha për studiuesit e muzikës popullore ka transkriptimi i 30 këngëve, bërë me profesionalizëm dhe kritere rigoroze shkencore. Po kështu, edhe tekstet e botuara në dialektin çam, përveç pasurisë gjuhësore, paraqesin interes edhe për elegancën e vargut dhe mjetet shprehëse, si edhe për finesën karakteristike të folklorit çam.

Libri "Muzika popullore shqiptare, këngët e çamëve", është homazh për bartësit e folklorit të mrekullueshëm çam, një libër që i kushtohet kujtesës gjithmonë të pagjumë dhe të trazuar. Ky libër e pasuron bibliotekën evropiane dhe i ndihmon studiuesit për t'iu rikthyer këngëve të çamëve.

DONATO MARTUCCI: "PËRSHKRIMET E BUKURA TË ÇAMËRISË MË KANË SHTUAR KURIOZITETIN PËR TA VIZITUAR"

Ju lutem, më flisni për veten, studimet dhe përpjekjet tuaja për të arritur sukses si studiues!

Kam studiuar në Universitetin e Salentos, në Lecce dhe jam diplomuar në Shkencat e Edukimit. Menjëherë më pas, fitova një konkurs të Ministrisë së Jashtme Italiane dhe bëra një stazh tremujor pranë Institutit Italian të Kulturës në Tiranë. Pas kthimit në Itali, kryeva një doktoratë kërkimore (Ph.D.) në "Teori dhe kërkim social". Më pas, kam dhënë për dy vjet lëndën Antropologji Kulturore në Universitetin e Salentos. Së fundi, kam fituar një bursë kërkimore mbi temën "Nocione, dije juridike dhe mënyra jetese në Shqipëri dhe në trevat ballkanike". Kam marrë pjesë në shumë simpoziume e takime mbi temën e albanologjisë, në Itali dhe në Shqipëri.

Çfarë ju shtyu të studionit historinë dhe kulturën shqiptare?

Gjatë kohës që kam ndjekur universitetin, kam njohur shumë shqiptarë të ardhur në Itali pas ngjarjeve të vitit 1991, në veçanti familjen e profesorit Halil Myrto (të cilit i kushtohet libri mbi tokat shqiptare të çliruara – Çamëria). Falë këtyre takimeve fillova të njoh kulturën shqiptare e më pas vendosa të hartoj tezën time të diplomës në Antropologji Kulturore mbi kanunet shqiptare. Kështu zuri fill rruga ime e studimeve mbi kulturën shqiptare, e cila më shtyu të hartoj edhe tezën e doktoratës mbi të drejtën zakonore shqiptare.

Po në historinë e Çamërisë, çfarë ju tërhoqi aq shumë sa t'ju bënte t'i kushtonit librin "Çamëria, tokat e çliruara shqiptare"?

Për sa i përket librit mbi Çamërinë, i cili sapo është përkthyer edhe në shqip, mund të them se është fryt i një pune të gjatë e të ndërlikuar në arkivat historikë të Accademia dei Lincei në Romë. Këtu kam gjetur materiale të pabotuara mbi Çamërinë, të hartuara nga studiues të mëdhenj të gjysmës së parë të shekullit të XX të Shqipërisë dhe çështjeve shqiptare dhe vendosa të thellohem në këtë temë. Pyeta veten për arsyen e hartimit të këtyre artikujve dhe mbi të gjitha, përse nuk e panë kurrë dritën e botimit. Së këtejmi lindi interesi im shkencor për "Tokat shqiptare të çliruara (le terre albanesi redente)". Në vijim u përpoqa të rindërtoj pasqyrën e lëndës së kësaj vepre, përmes qindra letrave ndërmjet autorëve të artikujve dhe Qendrës së Studimeve për Shqipërinë, që kishte porositur librin. Pra kam rindërtuar të gjithë vëllimin, ashtu siç ishte menduar për t'u botuar më 1941-1942, kam gjetur të gjithë artikujt e shkruar dhe kam bërë një punë të gjatë redaktuese, kryesisht për pajisjen me shënime në fund të faqes. Më pas kam shkruar një studim të gjerë hyrës, në të cilin shpjegoj kontekstin historiko-politik të projektimit të një vepre të tillë dhe shkaqet se përse ajo nuk e pa kurrë dritën e botimit. Ka qenë një punë e gjatë dhe e vështirë.

Çfarë keni evidentuar në këtë libër?

Ky libër ishte menduar për t'u botuar pas bashkimit të Italisë me Shqipërinë, menjëherë pas thyerjes së Greqisë dhe Jugosllavisë nga aleanca italo-gjermane, kur Italisë (dhe Shqipërisë) iu dhanë tokat e Kosovës dhe Çamërisë. Qendra e Studimeve për Shqipërinë vendosi të përkujtojë krijimin e një Shqipërie të Madhe, të kryer falë ndihmës së Italisë, duke botuar dy vëllime shkencore me ndihmesat e të gjithë studiuesve më të njohur italianë e shqiptarë, vëllime që mbanin titullin "Tokat shqiptare të çliruara (Le terre albanesi redenti)". Vëllimi i parë, që i kushtohej Kosovës, u botua në vitin 1942, ndërsa i dyti, që i kushtohej Çamërisë dhe tashmë i gatshëm, nuk u botua kurrë. Në hyrjen time shpjegoj se shkaqet që e detyruan Qendrën e Studimeve të shtynte botimin e më pas ta anulonte atë, ishin të natyrës politike dhe kishin të bënin mbi të gjitha me marrëdhëniet ndërmjet Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë. Me përfundimin e luftës dhe humbjen e Italisë libri u quajt "i tejkaluar" nga ngjarjet historike, pra Italia nuk ishte më në gjendje të garantonte ekzistencën e Shqipërisë së Madhe, e për këtë arsye, botimi u anulua.

Në vëllim gjejmë artikuj tejet interesantë që hedhin dritë mbi aspekte të ndryshme historike, artistike dhe botanike të Çamërisë: 1) Zotërimet mesjetare italiane në Çamëri (I domini medievali italiani in Ciamuria), nga Gennaro Maria Monti; 2) Qëndresa dhe ruajtja e gjuhës shqipe në Epir dhe shtysa letrare e Çamërisë (Resistenza e conservazione della lingua albanese nell'Epiro e propulsione letteraria della Ciamuria), nga Gaetano Petrotta; 3) Arti në zonën e Çamërisë (L'arte nella zona della Ciamuria), nga Sergio Bettini; 4) Ilirët në Epir (Gli Illiri nell'Epiro), nga Domenico Mustilli; 5) Për njohjen dhe shfrytëzimin e florës ngjyrosëse shqiptare (Per la conoscenza e lo sfruttamento della flora tintoria albanese), nga Antonio Baldacci.

Mendimi juaj si studiues mbi gjenocidin kundrejt popullsisë çame?

Kërkimet e mia mbi Çamërinë janë përqendruar kryesisht në periudhën e Luftës së Dytë Botërore dhe mbi këndvështrimin fashist të kësaj gjendjeje. Duhet të them se fashizmi u përpoq t'i shfrytëzonte në të mirë të vet ndjenjat irredentiste dhe etnike të shqiptarëve, që me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1912-1913, mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë.
Shumë kronika të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, sjellin episode të veprimeve luftarake që banditë grekë kanë kryer mbi shqiptarët e Çamërisë, duke dhënë shpesh gjykime mjaft të ashpra ndaj mizorisë së grekëve.

Duke qenë se puna juaj konsiston në studime kërkimore shkencore, a keni gjetur ngjashmëri ndërmjet kulturës shqiptare me ndonjë nga vendet e tjera që ju keni studiuar?

Ka mjaft ngjashmëri ndërmjet kulturës shqiptare dhe asaj të popujve mesdhetarë. Nga këndvështrimi i të drejtës zakonore, kjo është shumë e qartë. Këtyre ngjashmërive u kam kushtuar një paragraf të librit tim të fundit: Die Geëohnheitsrechte der albanischen Berge: Die Kanune. Mit einem unedierten Manuskript über den Kanun der Mirdita (E drejta zakonore e maleve shqiptare: Kanunet. Me një dorëshkrim të pabotuar të Kanunit të Mirditës, Verlag Dr. Kovaè, Hamburg, 2013). Përveç ngjashmërive të afërmendshme me kulturën otomane, mund të hasen edhe ngjashmëri më pak të pritshme, si ato me të drejtat zakonore të Italisë së Jugut ose të Sardenjës dhe Korsikës, ose edhe me atë të krahinës së Manit në Greqi. Gjithsesi, këto ngjashmëri shtyhen edhe shumë më larg në kohë dhe kanë të bëjnë edhe me të drejtën romake ose të drejtat gjermanike. Por kjo është një temë e ndërlikuar që ka nevojë të trajtohet në mënyrë të thelluar.

Duke qenë se keni kryer studime shkencore si në veri ashtu edhe në jug të Shqipërisë, mund të më thoni nëse ka dallime kulturore ndërmjet tyre, edhe pse i përkasin të njëjtës kulturë? Cilat janë ato?

Ndërmjet veriut dhe jugut të Shqipërisë, besoj se ka dallime nga këndvështrimi kulturor dhe social, por edhe shumë ngjashmëri. Këto dallime rrjedhin në thelb nga peripecitë e ndryshme historike që kanë lënë gjurmën e tyre në trevat e veriut dhe në ato të jugut. Këto ngjarje kanë sjellë dallime në gjuhë, në fe, në organizimin social, në mënyrën e të veshurit etj. Kështu ndodh në të gjitha kombet, edhe në Shqipëri, vendet mbajnë vulën e përvojës historike që kanë përjetuar.

Sa libra të tjerë me tematikë Shqipërinë keni botuar ose keni në plan?

I kam kushtuar Shqipërisë gjithçka që kam shkruar, pra mbi njëzet artikuj shkencorë të botuar në revista ndërkombëtare, ndër të cilët shumë artikuj mbi të drejtën zakonore shqiptare, të tjerë mbi disa udhëtarë që kanë vizituar Shqipërinë (Durham, Baldacci, Lorenzoni), mbi figura të mitologjisë shqiptare, si lugati, etj. Kam përgatitur botimin italisht të Kanunit të Lekë Dukagjinit, kam shkruar tre libra mbi kanunet shqiptare: Il diritto consuetudinario albanese: il Kanun (E drejta zakonore shqiptare: Kanuni; Shtëpia Botuese e Librit Shkollor e re, Tirana, 2005); I Kanun delle montagne albanesi. Fonti, fondamenti e mutazioni del diritto tradizionale albanese (Kanunet e maleve shqiptare. Burimet, themelet dhe ndryshimet e së drejtës tradicionale shqiptare; Edizioni di Pagina, Bari, 2010); Die Geëohnheitsrechte der albanischen Berge: Die Kanune. Mit einem unedierten Manuskript über den Kanun der Mirdita (E drejta zakonore e maleve shqiptare: Kanunet. Me një dorëshkrim të pabotuar të Kanunit të Mirditës; Verlag Dr. Kovaè, Hamburg, 2013). Veç këtyre kam shkruar librin mbi tokat shqiptare të çliruara: Le terre albanesi redente: Ciameria, (Comet Editor Press, Marzi, 2012), i përkthyer së fundmi në shqip dhe i botuar në Shqipëri nga Instituti i Studimeve për Çamërinë. Së fundi, nga fundi i këtij viti dhe fillimi i vitit të ardhshëm do të botohet një libër i imi, mbi Kanunin e Skënderbeut, në bashkëpunim me profesorin Genc Lafe.

E keni vizituar Çamërinë? Çfarë përshtypjesh ju ka lenë kjo trevë?

Ende nuk e kam vizituar Çamërinë, por jam shumë kureshtar për ta parë, pasi kam lexuar shumë përshkrime mjaft të bukura. Shpresoj që të kem mundësi të shkoj sa më parë të jetë e mundur.

ALI DEMI

Ali Demi lindi në Filat, në 18 janar të vitit 1918. Po aty përfundoi shkollën fillore. Në vitin 1927, nëpërmjet një burse studimi vazhdoi studimet në konviktin "Çamëria" të Sarandës, ku kishte filluar të frekuentohej nga fëmijë çamë të cilët mësonin në gjuhën amëtare. Më pas, ai ndoqi për katër vjet gjimnazin në Gjirokastër, ku organizoi edhe shoqatën "Skënderbeu" dhe "Qepa". Pas ngjarjeve të kryengritjes antizogiste të Fierit, një vit më vonë, bashkë me shokët e tij Themo Vasi dhe Njazi Demi, Ali Demi organizoi revoltën e nxënësve për kushtet e këqija të jetesës, por Ministria e Arsimit i përjashtoi të tre nga shkolla. Pas kësaj ngjarjeje, u regjistrua në gjimnazin e Tiranës, ku njihet me Qemal Stafën dhe Vasil Shanton dhe antarësohet në Grupin Komunist të Shkodrës. Me përfundimin e studimeve, u bë punonjës provizor në Post-Telegrafën e Tiranës.

Në fillim të luftës italo-greke, Ali Demi u angazhua në batalionin shqiptar "Tomorri" dhe shkoi në front, por qëllimi i tij ishte organizimi i sabotimit të kësaj lufte. Ai ishte një nga organizatorët e manifestimit të madh antifashist në Tiranë. Më 7 prill të vitit 1942, bie në sy të spiunëve të kuesturës, të cilët e arrestuan dhe torturuan. U dënua me 23 vjet burg. Në shtator të vitit 1942 u organizua demonstrata e madhe e grave dhe e popullit të Tiranës para burgut, ku u vra edhe Mine Peza. Atje ai organizoi hapjen e kanalit nga të burgosurit politik dhe më 29 prill të vitit 1943, në tentativën e dytë për arratisje, Ali Demi, ia arriti qëllimit. Më tej, për të filloi një jetë e re si komisar i batalionit "Çermenika", ku mori pjesë në disa aksione. Pas një udhëtimi të gjatë në malet e Çermenikës, në vitin 1943, Ali Demi arriti në Vlorë në kohën e vështirë të luftës, ku u caktua sekretar organizativ dhe më pas sekretar politik i Komitetit të Pratisë së Qarkut të Vlorës, një nga qarqet më të mëdha të luftës së Frontit Nacioanal-Çlirimtar. Në 19 dhjetor të vitit 1943, në një bazë të Kaninës së Vlorës, u rrethua nga ballistët dhe u qëllua për vdekje. Ali Demi vdiq në vitin 1943, në moshën 25-vjeçare. Në 5 korrik të vitit 1945 u shpall "Hero Kombëtar" nga Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar, me motivacionin "Udhëheqës dhe punëtor i palodhur, shembull heroizmi dhe obnegacioni të pashoq gjatë luftës Nacional-Çlirimtare. Ishte dhe mbetet një nga figurat më të shquara të brezave të sotëm dhe të së ardhmes së popullit shqiptar". Më tej, u dekorua nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me dekoratat: "Urdhëri i Flamurit", "Medalja e çlirimit"," Medalja e Trimërisë"," Medalja e Kujtimit". Emrin e Ali Demit e mbajnë shkolla të ndryshme në Shqipëri, veçanërisht në Tiranë dhe në Vlorë, si edhe në institucione të ndryshme kombëtare. Në përkujtimin e veprës së tij, janë ngritur një sërë bustesh.

SHKOLLA VERORE: 1913-2013 – 100 VJET ÇËSHTJE ÇAME

Është bërë tashmë traditë për Institutin e Studimeve për Çamërinë organizimi i shkollës verore në qytete të ndryshme të Shqipërisë, por edhe jashtë saj. Qëllimi i kësaj iniciative është evidentimi i çështjes çame dhe njohja e saj tek të rinjtë, të cilët, ndërsa kalojnë një ekspeditë të këndshme në shoqërinë e njëritjetrit, mësojnë më shumë rreth Çamërisë dhe kësaj çështjeje, falë tematikave të shumta gjatë leksioneve të mbajtura nga profesorë dhe studiues të ndryshëm, si Enver Kushi, Irakli Koçollari, Hajredin Isufi, Ahmet Mehmeti etj. Ky ishte viti i gjashtë i realizimit të kësaj eksperience, por këtë herë, pas dy përvojave të fundit në Ulqin dhe Pejë, shkolla verore u rikthye në qytetin bregdetar të Sarandës.

Rrugëtimi nisi në datën 25 korrik dhe përfundoi më 28 korrik. Tematika e sivjetshme që u trajtua gjatë leksioneve dhe diskutimeve ishte: "1913-2013 – 100 vjet çështje çame".

Çelja e këtij aktiviteti u bë nga drejtori ekzekutiv i Institutit të Studimeve për Çamërinë, Gjergj Xhafa, i cili sqaroi rëndësinë e aktiviteteve të institutit në promovimin e shkrimeve historike për Çamërinë dhe evidentimin e të vërtetës historike.

Profesor Hajredin Isufi trajtoi gjerësisht temën "Lidhjet e Çamërisë me krahinën e Sarandës", duke shqyrtuar nyjën lidhëse tradicionalisht të pashkëputur ndërmjet dy zonave të krahinës së Çamërisë, Sarandë-Konispol. Profesori u ndal tek mbështetja që konispolasit i dhanë çamëve dhe anasjelltas, në krijimin e një çete të armatosur në Konispol kundër bandës së Vasil Putecit, vrasësit të themeluesit të Klubit të Janinës, Kadri Gjata. Leksioni i profesor Hajredin Isufit vijoi me analizimin e ndërthurjes së veprimtarisë së atdhetarëve shqiptarë nga Çamëria, në luftën kundër fashistëve italiano-gjermanë, me qëllim që me anë të dokumenteve të faktuara të rrëzohet propaganda boshe e bashkëpunimit të çamëve me nazi-fashistët.

Duke vijuar më tej me leksionet, interesin e studentëve pjesëmarrës në shkollën verore, e zgjoi profesor Irakli Koçollari me temën "Informacionet e para sekrete të panjohura të europianëve për Çamërinë, shtrirjen e saj, popullsinë, përkatësinë etnike dhe fetare", i cili u ndal në disa raporte ushtarake mbi trevat e Çamërisë, gjatë periudhës së Napoleon Bonapartit. Vëmendja u përqendrua mbi raportin e W. Martin Ligut, oficerit anglez 24-vjeçar, dërguar Ministrit të Jashtëm anglez, Hausberry, i cili ka theksuar se "Shqipëria fillon nga brigjet e Artës dhe shkon edhe më tej drejt Veriut". Vlera e këtyre informacioneve qëndron në rëndësinë e njohjes nga studimet në mënyrë asnjëanëse të këtyre territoreve. Më tej, profesori, duke prezantuar telegramë të banorëve të ndryshëm mbi masakrat ndaj çamëve, si edhe të dhëna mbi

masakrat në Jugun e Shqipërisë, nxori në pah dokumenta dhe fakte të reja historike mbi Çamërinë.

Prof. Enver Kushi në shtjellimin e veçorive të kulturës çame, nën temën "Këngët e çamëve në një botim gjerman dhe një këngë vaji", paraqiti disa veçori të kësaj kulture duke arritur në përfundimin se kultura çame: është pjesë e pandarë e kombit shqiptar dhe ajo mbart vlera shqiptare; shpreh vlerat e një kulture të lashtë dhe mbart shtresëzime të ndryshme të pellazgëve, ilirëve, të një shtrese arkaike të kulturës shqiptare; është e ndikuar pozitivisht nga kultura materialo-shpirtërore greke, por edhe anasjelltas; është kultura e një popullsie e zhvendosur nga trojet e veta dhe është e lidhur ngushtë me mjedisin ku është krijuar.

Profesor Ahmet Mehmeti analizoi shkeljet flagrante të të drejtës ndërkombëtare të Greqisë, lidhur me trajtimin e të drejtës së popullsisë çame, duke përmendur rastin e të ashtuquajturës "reformë agrare". Ndërsa në leksionin e radhës, profesori realizoi një vështrim të përgjithshëm për letërsinë shqipe në Çamëri, si edhe për studimet në trojet shqiptare dhe në vendet europiane, qysh nga shek. XVI me Maksim Mathioti, deri në periudhën e robërisë greke.

Tema e fundit u trajtua nga Gazmend Haxhia, i cili trumbetoi rëndësinë e rolit të lidershipit në çështjen çame, duke theksuar se kjo çështje madhore kombëtare ka nevojë për kontributin e gjithkujt.

Pjesë e rëndësishme e programit ishin vizitat e ndryshme në Konispol, në qytetin ku gjurmët e sjellin më pranë Çamërinë, duke vijuar me varrezat monumentale të Kllogjerit, ku pjesëmarrësit e shkollës verore kujtuan të rënët e pafajshëm të atij gjenocidi të tmerrshëm, si edhe me vizitën në shtëpinë e Alush Takës, aktualisht në gjendje të rrënuar.

Leksionet u udhëhoqën nga profesorët më në zë të Shqipërisë, në mënyrë që informimi të ishte sa më i saktë, voluminoz dhe inovator, duke prekur aspektet më të rëndësishme në fushën historike, të drejtës ndërkombëtare, kulturës, gjuhës etj. Falë pranisë së këtyre profesorëve të nderuar, si edhe falë tematikave të sipërpërmendura, ndjekja e leksioneve pati një interesim të lartë nga studentët e rinj, gjë që u evidentua me një pjesëmarrje të lartë dhe të gjallë nëpër diskutimet mbi temat e shumta në interes të Çamërisë.

Interesimi i lartë për të qenë pjesëmarrës në shkollën verore, si edhe efektet e frytshme që ajo sjell tek të rinj të ndryshëm vit pas viti, e bën më të vlefshme vijimin e kësaj tradite. Në përfundim të edicionit të gjashtë të organizimit të këtij aktiviteti, Instituti i Studimeve për Çamërinë, e quan të përmbushur qëllimin mbi informimin e të rinjve të pranishëm, për t'i lenë vendin një tjetër grupi, në edicionin e radhës së shkollës së verës.

Nga ***Mona Agrigoroaiei***

KUSHTETUTA, EVROPA DHE MINORITETI ÇAM

Instituti i Studimeve për Çamërinë ka nxjerrë në botim një tjetër libër të vlefshëm për bibliotekën e të gjithë të apasionuarve pas dokumenteve historike. Libri, me autor Agron Alibalin, titullohet "Kushtetuta, Evropa dhe minoriteti çam". Shkrimet e përzgjedhura për botimin e këtij libri, autori i ka grupuar në katër kapituj: 1) Për Kushtetutën, 2) Për të drejtat e pakicave, 3) E drejta e zgjedhjeve dhe OSBE-ja, 4) BE-ja dhe Shqipëria.

Ndryshimet në Kushtetutë dhe kryesisht regjistrimi i popullsisë, kanë sjellë në vëmendje të drejtat që duhet të kenë pakicat dhe abuzimet që bëhen në emër të tyre. Ngulmimi i OSBE-së për reformë të re zgjedhore, integrimi në Evropë dhe standardet që duhen përmbushur për të realizuar qëllimin, janë synimet më madhore, si të qeverisë ashtu edhe të opozitës. Këto janë disa nga çështjet që autori ka trajtuar në këtë libër me karakter juridik, duke bërë analizimin e dokumenteve, situatave dhe ngjarjeve që lidhen ngushtë me të drejtën e brendshme dhe ndërkombëtare. Edhe pse shkrimet kanë karakter juridik dhe analitik, janë të shkruara në mënyrë shumë të thjeshtë dhe të kuptueshme për këdo. Pavarësisht datës që mbajnë apo përsëritjeve të pashmangshme të ideve kur flitet për tema të tilla të ngjashme, temat vijojnë ende të jenë bashkëkohore, duke të kujtuar realitetin aktual të Shqipërisë.

Midis të tjerash, në kapitullin e dytë, Agron Alibali i ka kushtuar një vëmendje të veçantë çështjes çame, aspektit historik, juridik, si edhe aktualitetit dhe miratimit të rezolutës. Autori e ka nisur analizën e vet për këtë çështje, me këto tematika: përpjekjet e para të çamëve për drejtësi, faktorët që kanë sjellë pengesa për realizimin e saj, e drejta e riatdhesimit, roli i BE-së mbi këtë çështje, roli i Greqisë dhe qeverisë shqiptare, si edhe dëshmia e Pukëvilit. Më tej, libri vijon me reflektimin për 65 vitet e gjenocidit çam, por edhe me shqyrtimin e rolit të misioneve ushtarake



britanike gjatë luftës në Shqipërinë e Poshtme. Analizën e kësaj teme, autori e ka përfunduar me evidentimin e çështjes së rezolutës çame, ku pas pasqyrimit të domethënies dhe rëndësisë së rezolutës, Agron Alibali ka vijuar me arritjet dhe mangësitë që kanë sjellë zvarritjen e kësaj çështjeje, por edhe me mundësinë që kjo rezolutë të jetë miratuar qysh në vitin 2004.

Në këtë botim, të bie në sy përgatitja e dukshme e autorit përpara analizës së problemeve dhe propozimeve për rrugëzgjidhjen e tyre. Përballja e tij me botën profesionale dhe akademike, si në Shqipëri, ashtu edhe në SHBA, i ka dhënë atij besimin që të shprehë hapur dhe të argumentojë mendimin, qoftë ai në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ekspertët e fushës, sidomos ata të huaj. Ky respekt për veten dhe vlerat e ardhura si pasojë e punës dhe përgatitjes, kanë bërë të mundur realizimin e këtij libri të vlefshëm në hartimin, zbatimin, mbrojtjen e politikave, dokumenteve përkatëse dhe synimeve kombëtare.

NGA ABEDIN RAKIPI

KUSHTRIMI ÇAM

Folu bijëve të Prevezës,
të marrin fjalë e të mos lëkunden
se vet Zoti e mbolli farën tonë në Çamëri.
Si një zë nga Kallamata që ngjall varre e çon shpata,
vjen kushtrimi nga Janina,
çohet në këmbë gjithë Gumenica,
vrapojnë djem pleq nga Filati,
ndizet zjarr e flakë Kosturi.
O Meçovë, Meçova e vjetër
sa çamë solle me vete
derdhet populli në mejdan
amanet Çamërinë e kanë.
Del në bedena Ali Pasha,
vijnë kuaj të bardhë nga Parga,
Ej o nënë Paramithia po buçet sot me ezan
po lidh besën Çamëria të luftojmë për vatan,
lidhur zemrat thonë së bashku:
Çamëri të qofshim falë.
Margëlliç o gur e shkëmb
gjithë këta burra ngritur në këmbë,
del me valle Osman Taka
vijnë flamurë e trima nga Arta,
lufton me krajlat Hasan Tahsini
i thotë Europës jam Çamëri,
godet me penë Faik Konica
pabesitë e barbarëve nga Atika.
Kalëron Abedin Dino
Shqiptar Abedin çami,
na çe kemi Follorinë, luftë e gjak për Çamërinë
shihni si ishtë dheu sot, vllastimi të mblidhen,
të bënjë vllezrë luftë për tat dhe për Shqipërinë.
Vjen një erë nga Ajdonati
dhe s'lëshon flamur nga dora
bini trima mbi Junanë, Dushmani na zu vatanë
bini për nënën Çamëri se neve na erdhi ora.

NGA NAMIK MANE

ÇAMËRISË

Këtë natë të ftohtë shkurti,
U ngarkova:
Plot me farëza lirie
Dhe u nisa për tek ty,
Që të mbjell në tokën tënde,
Këto farëza, Çamëri.

Nga Kosova fishekzjarret
Dritë, ditë, ma bëjnë rrugën,
Ndaj dhe unë nuk njoh pengesa,
Shpejt e shpejt, po vij tek ty,
Moj dhimbshuria ime,
E pathinjura, Çamëri.

Më djeg gjoksi prej shumë vitesh
Nga një mall që s'ka përmasa…
Dhe në u thafshin oqeanet
Se nxëjnë dot këtë mallin tim,
Vetëm ti mund ta mbash brenda,
Në gjoksin tënd, moj Çamëri.

Hapi krahët, prite birin,
Po të vjen…
Do shkëmbejmë ne të dy,
Fjalë bese, këtë mbrëmje:
Do t'i mbush unë gjithë kullotat,
Plot e plot, me klumushtore,
Se të pjellat, do i kemi,
Shumë të mbara këtë vit,
Dil, moj Çamëri, më prit!

Frederik Buasona (Frédéric apo Fred Boissonnas, 1858-1946) ishte fotograf zviceran i cili lindi në një familje të njohur fotografësh në Gjenevë. Mbahet mend kryesisht për fotot e hershme artistike të jugut të Ballkanit. Udhëtimi në rajonin e Ballkanit në vitin 1913 me historianin zviceran të artit Daniel Baud-Bovy ishte veçanërisht i frytshëm. Fotot e Buasonasë nga Çamëria dhe jugu i Ballkanit u botuan ndër të tjera në vëllimet: L'image de la Grèce: l'Epire - berceau des Grecs, Gjenevë 1915, dhe L'image de la Serbie: le berceau des serbes, Gjenevë 1919. Fotografitë e Greqisë, dhe në mënyrë të veçantë ato të Çamërisë në kohën e përfshirjes së saj në shtetin grek kanë jo vetëm rëndësi dokumentare por edhe një vlerë të lartë artistike. Ky koleksion i fotografive të Fred Buasonasë është vetëm një pjesë e vogël e fotografive që ai bëri në Çamëri dhe në jug të Ballkanit.

Frédéric (Fred) Boissonnas (1858-1946) was a Swiss photographer who stemmed from a well-known family of photographers in Geneva and is remembered primarily for his early photos of southern Balkans. His trip to the southern Balkans in 1913 with Swiss art historian Daniel Baud-Bovy (1870-1958) was particularly fruitful. Boissonnas' pictures of the southern Balkans were published in the volumes: L'image de la Grèce: l'Epire - berceau des Grecs, Geneva 1915, and L'image de la Serbie: le berceau des serbes, Geneva 1919. His photographs of Greece and, in particular, of Epirus and Chameria at the time of their incorporation into Greece, are not only of documentary value but also of great artistic skill. The present collection of the photographs of Fred Boissonnas is but a small portion of the photos he took in Chameria and the southern Balkans.

Plazhi i Pargës 1913 / Parga's beach 1913

Ura e Filatit 1913 / Filat's bridge 1913

Rrapi i Paramithisë 1913/
Plane tree in Paramythia 1913

Kështjella e Janinës 1913 / Janina's Castle 1913